

Galeria e Ministrisë së Kulturës
shpall:

KONKURS

për Programin Artistik të vitit 2022

Të drejtë konkurimi kanë krijuesit nga fusha e pikturës, skulpturës, dizajnit grafik, grafikës, instalacionit, fotografisë, videos, performancës dhe arkitekturës.

Aplikimet mund të jenë për ekspozita individuale dhe ekspozita kolektive kuratoriale.

KUSHTET:

1. Të drejtë konkurimi kanë të gjithë të cilët kanë ide / vepra të realizuara në këto fusha
2. Konkuruesit duhet të sjellin dhjetë (10) punime të shtypura me ngjyra, në formatin A4, me kualitet të lartë (minimum 600 x 800 dpi); apo video me kohëzgjatje prej maksimum 10 minuta, në format DVD.
3. Punimet duhet të jenë të realizuara viteve të fundit dhe të pa ekspozuara në GMK-ë.
4. Biografia profesionale.
5. Konceptin e punimeve apo ekspozitës.

VËREJTJE:

- Nuk pranohen punimet fizike (piktura, skulptura, etj.)
- Numri i punimeve që do të ekspozohen vendoset nga GMK-ë.

Dorëzimi i aplikacioneve: Aplikimet në zarf dërgohen në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çdo ditë pune nga ora 08:00 – 12:00, deri më datë 15.11.2021

Adresa: Galeria e Ministrisë së Kulturës, rruga UÇK, nr. 96 (kompleksi Qafa), 10000, Prishtinë, Kosovë.

Kohëzgjatja e konkursit: Konkursi është i hapur dyzet (40) ditë, 05.10.2021 – 15.11.2021

Data e fundit e aplikimit është: 15.11.2021 në ora 12:00.

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Formulari për aplikim mund të kërkohet me e-mail në: gmk@rks-gov.net dhe Gresa.Bytyqi@rks-gov.net.

Për Informata më të hollësishme mund të kontaktoni në tel. 038 212 912.